

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI⁵⁰, mbledhja e 6) me dt. 29.06.2021 (e martë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:


R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB)-i, 2022-2024
4. Shqyrtimi i kërkesës së DKA-së, për themelimin e Komisionit
5. Shqyrtimi i Raportit të DKA-së, sipas vendimit nr.-I-31, të dt.26.02.2021
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Burim Gërguri



Dalës-Izlazna

Nr. 1-SP
Br.

Data 18.06.2021
Datum

OBILIÇ-OBILIÇ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.31.05.2021, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Enver Gashi (AAK), Florije Jashari (AAK), Qendresa Dubova (AAK), Lulzim Bllaca (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatos Kurshumlija (LDK), Fatmir Bektashi (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Lulzim Sadiku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Armend Rushiti (LB), Nora Preniqi, (LB), Nazmi Gashi (Nisma), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkryetar i Komunës, drejtorët komunal, Avdyl Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete, dhe përf. i IZHL-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal, i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara:
3. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për faljen e tarifave vjetore të bizneseve private për vitin 2021
4. Dhënia në debat publik e Draft Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike
5. Shqyrtimi i raportit të Komisionit komunal për dhënien e pronave komunale
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Lulzim Sadiku – Unë në mbledhjen e fundit kërkoja që të jetë një pikë e veçantë për 5 fshatra të cilat janë në zonën e interesit, por edhe pse morëm premtimin nga kryesuesi dhe Nënkryetari, prapë nuk është në rendin e ditës. Vërtetë, ka nevojë të bisedohet për ato fshatra sepse ju e dini si është gjendja e tyre. Unë po shohë edhe nëpër rrjetet sociale që ata kanë të drejtë duke thënë as mos ndërto, as mos shpronëso dhe unë kisha me shtue as mos bisedo për këtë

çështje. Vërtetë, kryesues jemi marrë vesh që të formohet një Komision për me punue dhe kontribue në këtë drejtim, por fatkeqësisht kjo nuk është bërë dhe fshatrat Sibofc, Lajthishtë, Shipitullë dhe Hade, janë në gjendje të mjerueshme. Unë nuk po them të futet në rend dite, por vërtetë e kam marrë premtimin në mënyrën më shoqërore dhe kam mendue se sot jemi të përgatitur që ta formojmë një Komision, që në kuadër të saj të shqyrtohet edhe plani zhvillimor komunal, ti shikojmë rregullat, por fatkeqësisht nuk e kemi si pikë të rendit të ditës. Ne nuk kemi fuqi politike si opozitë, por them vetëm se kjo është keq.

Kryesuesi - Mendoj se ne do ta mbajmë një mbledhje të jashtëzakonshme për këtë çështje dhe jemi dakord që brenda muajit qershor kur ju vendosni ne mund të takohemi me shefat e grupeve për ta thirrë mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit. Ne do ti përgatitim të gjitha masat, ti thërrasim Ministrinë përkatëse dhe do ta debatujmë gjerësisht çështjen në fjalë. Ne jemi dakord që me planin e ri zhvillimor që me marrë vendim edhe Qeveria, që me gjetë një zgjidhje dhe të mos mbetet vendimi i vitit 2004, që 86 % e territorit me qenë zonë me interes të përgjithshëm.

Miratohet unanimisht rendi i ditës me propozimin që mbledhja e jashtëzakonshme të mbahet gjatë muajit qershor lidhur me çështjen e zonës me interes të përgjithshëm.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Lbinot Mirena me arsye.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga DEFZH-ja, për faljen e tarifave vjetore të bizneseve private për vitin 2021. Për një sqarim më detal rreth kësaj çështjeje fjalën ia japë drejtoreshës së DEFZH-së.

Zarife Behluli – Ne si Ekzekutiv kemi menduar se është një gjest i mirë falja e taksave komunale që i fakturojmë për ushtrimin e veprimtarisë bizneseve private në Komunën e Obiliqit. Për fakturim për vitin 2020, janë 130,800 €, që i kemi inkasue KEK-un dhe disa banka, që janë 64,950 €, për falje janë 63,500 €, ndërsa për inkasim mbeten edhe 10,350 €.

Lulzim Sadiku – Grupi i PDK-së, pajtohet në përgjithësi, është një veprim i mirë për ti lehtësuar dhe për të iu ndihmuar bizneseve. Prandaj, jemi pro kësaj kërrese, por kam një pyetje se a kanë hyrë edhe feramat

Kryesuesi – Të gjitha ato që janë të regjistruara përfshihen.

Fatos Kurshumlja – Edhe ne si grup parlamentar jemi pro faljes së tarfiave vjetore të bizneseve private dhe mendoj se është një ndihmesë sado pak e vogël për biznese dhe e përkrahim.

Nora Preniqi – Edhe LB-ja, e mbështetë iniciativën për falje të tarifave, por dua një sqarim rreth listës sepse ishte një person me emër e mbiemër sikurse unë dhe nuk kishte as numër të letërnjoftimit që e dallon se nuk jam unë. Prandaj dua të them se diçka duhet me dallue sepse mund të jetë konflikt interesi.

Kryesuesi – Sqaron se vendi i lindjes, atëisa dhe ditëlindja dallon në këtë rast.

Nazmi Gashi – Jo, vetëm me i falë që nuk ka diskutim, por me kërkue ndihmë edhe nga Qeveria, me ia shpjegue mirë rrethanat e Ndërmarrjeve, në çfarë kushte, në çfarë ambient dhe në çfarë mundësie janë duke punuar dhe vepruar me pengesa që dallojnë nga Komunitat tjera. Drejtoritë përkatëse duhet të bëjnë shkresë dhe analizë dhe me kërkue me arsyetim më të fortë që Qeveria ti merrë për bazë rastet e Ndërmarrjeve tona.

Kryesuesi – Me rastin e rishikimit të buxhetit, në qershor besoj nëse, është mundësia me Ministrinë e financave me krijue një fond si në vitin e kaluar dhe me iu dalë në ndihmë, sidomos atyre që janë me prioritet..

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht e aprovuan Vendimin për lirimin nga taksa vjetore komunale për bizneset private për vitin 2021.

Pika 4 e rendit të ditës -

Kryesuesi - Paraqet kërkesën e DSHPE-së, për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike.

Aziz Bici – Nëse, i referohemi Ligjit nr.05/L, neni 11 po lexoj: “Qeveria, Ministrinë përkatëse brenda 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji”. Ndërsa neni 12, po lexoj: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës”. Ky ligj mbanë datën 30.11.2016, të hyrjes në fuqi. Tani, logjikisht shtrohet pyetja ku janë premtimet e juaja se ju do ta implementoni këtë ligj në mandatin tanimë të dytë kur deri në zgjedhjet e ardhshme lokale nuk kanë mbetë edhe 5 muaj të plotë. Lidhur me kërkesën për daljen në debat publik të Draft Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike në zonën e rrezikuar mjedisore në Komunën e Obiliqit, konsideroj se është vonë që brenda 5 muajve të dilet në debat publik dhe të kryhet e gjithë procedura në tërësi, kur në fakt kjo veç se është dashur që të implementohet së paku para 4 viteve e gjysmë.

Lulzim Sadiku – Besoj se kjo Draft Rregullore për të dalë në dëgjim publik, duhet të jenë anëtarët e Kuvendit ata të cilët do të kontribuojnë që në dëgjimin publik kjo Draft Rregullore ta merrë formën shumë të thukët dhe shumë të madhe sepse është në interes të qytetarëve të Obiliqit. Mendoj se shumë Rregullore që kanë dalë në dëgjim publik, kanë qenë kopje dhe te kjo Rregullore kërkoj që të gjithë të jemi të bashkuar sepse është në interes të qytetarëve të Obiliqit dhe me ia dhënë një reputacion shumë të madh për arsye se na e kanë marrë ajrin, ujën dhe tokën. Ne duhet të bëjmë ftesë që të gjithë qytetarët në dëgjim publik të jenë sa

më masiv në kuadër të kësaj Rregulloreje, për ato që i thashë. Ne si grup parlamentar jemi pro kësaj kërkesë që të delë në dëgjim publik, njëkohësisht të mendoj edhe Qeveria që është duke e vazhduar punën ka paguar rrymë për pakicat që dihen shifrat dhe qytetarët e Obiliqit meritojnë që me kaluar kjo Draft Rregullore, me u paguar rryma sado që është shumë e vogël që po e shohë unë. Mendoj se do të bashkëpunojmë dhe punojmë të gjithë së bashku që kjo Rregullore të kalojë.

Fatos Kurshumlija — Edhe ne si grup jemi pro kësaj Rregulloreje, vetëm kisha me kërkuar nga Drejtoria nëse formohet ndonjë Komision, me gjetë ligjin dhe nenin adekuat sepse është hera e tretë që vjen në Kuvend çështja e subvencionimit të energjisë elektrike. Nëse, nuk gaboje para 2 viteve, një grup ka dalë dhe i ka marrë numrat e orëve. Pra, kur të fillojmë është mirë me ditë dhe me gjetë nenin sepse është hera e tretë që po merremi me këtë çështje.

Nora Preniqi — Edhe ne e përkrahim këtë iniciativë dhe shpresojmë që të zbatohet.

Naim Miftari — Ne si Ekzekutiv jemi të përqëndruar që të punojmë për interesat e qytetarëve të Komunës tonë. Unë nuk arrij ta kuptoj qëndrimin politik të LVV-së dhe kërkoj prej tyre që të jenë më parimor në interesat e qytetarëve të Komunës tonë.

Aziz Bici — Drejtor, me më thënë dikush për parimet, jo veç që synohen vërtetë, e kisha falenderuar, por me më thënë ti si drejtor me këtë Kryetar, me këto premtime që 4 vjet, që thoni ka herë implementimi i Ligjit për Obiliqin dhe nuk keni kërkuar asnjëherë ndihmë, së paku prej neve asambleistëve të LVV-së, asnjëherë nuk keni kërkuar ndihmë për me dhënë kontributin tonë, unë mendoj se nuk ke të drejtë. Unë them se premtimet që i kemi dhënë të gjitha dhe jemi zotuar edhe ne se sikur ta fitojmë pushtetin kemi me implementue këtë ligj, keni qenë ju atë që e keni bërë dhe as për së afërmi nuk i keni gjetë mundësitë për me implementue këtë ligj, por vetëm kjo Rregullore për subvencionimin e energjisë elektrike. Lexoje ligjin e të njofton se si duhet hartuar projekte të atilla që i tregojnë qytetarit të komunës sonë se qysh me ruajtë ujin, qysh me ruajtë ajrin, e qysh me ruajtë tokën sepse kjo edhe është arsyeja pse duhet një ligj i veçantë për Obiliqin. Prandaj, ju duhet të dilni e të na tregoni tash e konkretisht se çka është bërë në këto çështje.

Kryesuesi — Të nderuar anëtarë të Kuvendit, është fatbardhësi që kjo qeveri e ka bërë ligjin dhe implementin e tij. Natyrisht se zbatimi i ligjit ka vështirësi, është aprovuar në vitin 2016 dhe është dashur 3 vjet me prit për me implementue, që mendoj se edhe qeveria e re do të gjejë mirëkuptim dhe do të zbatohet ky ligj. Sa i përket Rregullores për subvencionimin e energjisë, ligji është adekuat por na duhet ndihma dhe Komisionet përkatëse.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 17 vota e aprovuan Vendimin për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike për zonën e rrezikuar mjedisore në Komunën e Obiliqit.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi — Paraqiti raportin e Komisionit për dhënien e pronave komunale. Konsideroj se raporti i ardhshëm i cili do të na vjen pas 3 muajve, do të jetë një raport më specifik dhe do të shohim se në cilën fazë kanë arritë bizneset me i respektue marrëveshjet që i kanë marrë.

Lulzim Sadiku — Raporti është një raport i përshkruar i dhënies së pronave komunale dhe nuk është i specifikuar, do të thotë është një raport i thjeshtë që vërtetë, nuk di çka të them. Ndoshta, për shkak të pandemisë dhe rrethanave tjera është një raport që Komisioni nuk e ka specifikue se çka kanë ofruar operatorët dhe çka kanë kërkuar anëtarët e Kuvendit në raport. Është një raport i thjeshtë që të dhënat i ka se kush e ka pronën dhe ku është, kështu që ne nuk kemi çka të themi si grup. Besoj se nësa na e sjellin raportin brenda 3 mujorit tjetër, atëherë ai raport duhet të jetë shumë më cilësor dhe të jetë një raport me të dhënat e sakta. Mirëpo duhet të iu kërkojë Komisionit edhe çka ne po kërkojmë sepse e kanë bërë një raport të thjeshtë dhe të specifikojnë çështjen e raportit pse, ku është, çka kanë kërkuar, a iu ka dhënë leja e ndërimit dhe a ka të drejtë me iu dhënë leja ndërimit apo jo. Po ashtu, duhet të dijmë se a është nën sistemin e ujitjes që iu ka dhënë toka apo nuk është, a e ka kthyer Ministria e bujqësisë, a janë të gjitha Ministrinë dakord për këtë çështje, në mënyrë që ne ti dijmë të dhënat e sakta.

Kryesuesi – Unë e falenderoj Komisionin që kanë fillue me bë një raport sipas gjendjes faktike me emër e mbiemër, me numër të parcelës, që për shkak të transparencës të dijmë se ku janë pronat, kush i ka marrë dhe si po i shfrytëzon.

Aziz Bici– Raporti i Komisionit për verifikimin e pronave të dhëna në shfrytëzim për 99 vite, në përbërje prej Zejnullah Krasniqit, Kryetar me anëtarët: Nerimane Kelani dhe Valbona Krasniqi, konsideroj se ky raport përveç informacionit që na është ofruar se çka kanë parë me sy dhe çfarë kanë thënë subjektet, ky Komision nuk i është referuar kontratave në mes të Kryetarit dhe subjekteve në fjalë, të bazuara në ligj që kërkohet në planin dinamik për zbatimin e këtyre projekteve. Nga Komisioni presim që në të ardhmen e afërt sipas meje brenda 2 muajve, sado që kryesuesi tha ndoshta për 3 muaj. të na sjellin një raport me rekomandime të bazuara në plane dinamike të këtyre projekteve, me qëllim që të dihet saktësisht se a janë duke i respektuar marrëveshjet dhe aftet ligjore të nënshkuara në mes të Kryetarit dhe subjekteve në fjalë.

Kryesuesi – Ne në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, kemi kërkuar edhe listën e pronave që janë dhënë nga viti 2001 e tutje, në mnyrë që ta kemi një pasqyrë për çdo qeverisje të dijmë se si janë shfrytëzuar pronat komunale. Mendoj se Komisioni do ta sjellë raportin e specifikuar brenda 3 muajve, ashtu edhe siç u kërkua nga anëtarët e Kuvendit komunal.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi– Ju njoftoj se kërkesa nga Musli Pajaziti i është rekomanduar DPUKP-së, për shqyrtim. Pastaj, ishte kërkesa nga Sala Paci, e cila i është rekomanduar DSHPE-së për shqyrtim. Në ndërkohë më ka ardhë një kërkesë e përsëritur nga operatori “Kastrioti “SH.P.K. për ndihmë financiare, prandaj ju lus që ti jepni përgjegje. Po ashtu, sot ka ardhë një kërkesë nga DPUKP-ja, për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.-I-110, të dt.30.10.2017.

Naim Miftari – Është mirë të bëhet plotësimi dhe ndryshimin i këtij vendimi sepse edhe Ligji për planifikimin hapësinor e potencon që planet zhvillimore duhet të jenë së paku për 8 vite. Unë nuk e di në vitin 2017, qysh është bërë ky lëshim, por është mirë të bëhet ky përmirësim.

Lulzim Sadiku – Pajtohem se është bërë gabim teknik, por nuk po e kuptoj pse Komuna jonë ende nuk ka plan zhvillimor komunal. Ne jemi në procedurë, por nuk kemi sepse ne e kemi paguar një kompani sa e di unë nga Kuvendi që vërtetë, me u marrë me këtë çështje.

Kryesuesi – Z.Lulzim, ka të drejtë dhe plani zhvillimor komunal do të jetë në debat publik, do të jetë në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin komunal për shqyrtim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 17 vota për e aprovuan Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.-I-100, të dt.30.10.2017.

Pika e 7 e rendit të ditës

Aziz Bici – Unë e kam fjalën për Mazgitin e Epërm, në rr.”Afrim Zhitia” që fillon nga Tyrbja deri në Mazgitin e Poshtëm te shtëpia e Morinëve, që shkojnë andej. Kompania ka filluar riparimin e rrugës, por ka bërë prerjen e asfaltit ku thellësia e këtyre gropave është shumë e madhe. Kompania përkundër faktit që ka pasur për detyrë që të lehtësoj lëvizjen e lirë të qytetarëve, duke hedhur një sasi të zhavorrit në të dy skajet, ata nuk e kanë bërë atë. Unë po e paraqes këtë çështje në Kuvend, për shkak se ky gabim i tyre është duke vështirësuar tej mase lëvizjen e qytetarëve me automjete në atë pjesë. Përveç, që po e vështirëson lëvizjen gjithashtue dhe po dëmtohen automjetet për shkak se duke u munduar që të ecin skajve, drunjët anash po i dëmtojnë këto vetura përveç teknikisht edhe ngjyrën e tyre. Nëse, në këtë projekt nuk janë të përfshira të ndërtohen edhe kanalet kulluese si dhe gypat nëpër të cilat kalon uji nga njëra anë në tjetrën, do të vazhdon që uji i tërheqë dhe të kaloj nëpër asfalt sikurse deri më tani, prapë kjo rrugë nuk do të shkoj largë dhe do të prishet. Prandaj, unë vijë në përfundim se këtu, nuk po ka interesim që punët të kryhen në mënyrë cilësore, në mënyrë që ato rrugë të jenë të qëndrueshme dhe më afatgjata, pra ti plotësojnë kushtet dhe përgjegjësitë qoftë teknike, qoftë cilësore. Çështjen tjetër e kam rreth seancës së kaluar, e kam ngritë problemin e familjes Omeroviq Ekrem, ju Nënkyetar dhe anëtarë të Kuvendit, në seancën e kaluar veç jeni të njoftuar lidhur me problemin që e ka familja Omeroviq Ekrem, nga një person i cili vazhdon ti bëjë presion me ia lirue banesën. Nënkyetar, përveç tjerash jeni deklaruar se objekti i shkollës “Nikolla Tesla” në Obiliq, banesat

të cilat janë në shfrytëzim nga disa familje nuk janë në menaxhim të Komunës. Mirëpo, një nga pyetjet e mia nga të cilat unë nuk kam marrë përgjegje ka qenë në menaxhim të kujt janë këto objekte. Njëra nga arsyet që kërkon trajtim urgjentë është sepse familja e Omeroviq Ekrem, vazhdon të jetë nën presion të këtij personi duke shkuar te dera e tyre dhe duke e kërcënuar atë familje që ta liroj banesën. Dyshimi është se institucionet lokale si ato komunale, ashtu edhe Policia e Kosovës, po e neglizhojnë rastin në fjalë. Prandaj, kërkesë e imja është që të ndërmerri masa menjëherë dhe të sqarohet kjo situatë, ku një familje kërcënohet në vazhdimësi. Tash, kjo familje përveç presionit nga ai qytetar që e konsideron atë pronë të vetën pa asnjë dëshmi që e konfirmon këtë, është edhe nën presionin e organeve komunale si dhe policisë, sidomos tani. E treta, është te Tregu dhe unë i kam 2 pyetje rreth ndërtimeve të Tregut kur do të bëhet përrurimi i tregut, kur jeni zotuar në muajin janar për vitin 2021, nëse nuk gaboj se do të jetë muaji kur do të përrurohet në treg. Pyetja tjetër është se a mendoni që i plotëson kushtet e nevojshme të një tregu, për shkak se unë kam dyshime për këtë dhe nuk besoj se do ti plotëson kushtet kur bëhet vlerësimi nga ekspertët në mënyrë që të bëhet pranimi teknik edhe nga aspekti sanitar duke u bazuar në mosplotësimin e kushteve që parashihen me ligj.

Kryesuesi – Besoj se Ekzekutivi, do të japë përgjegje në këto pyetje, por mund të them se prona është komunale te tregu dhe kjo është çështje e kryer.

Arbnore Nasufi – Unë kam një pyetje për Nënkryetarin se në seancën e kaluar kolegu Labinot Mirena, ka kërkuar sqarim lidhur me mospagesën e Komisioneve. Ju keni thënë se deri më tani ju nuk më jeni drejtuar mua, se kjo punë kishte me u krye moti. Prandaj, dua të di se deri ku keni arritë me këtë çështje.

Nora Preniqi – Dua, ta potencoj një shqetësim të banorëve të ndërtesave këtu të lagjes së vjetër të Obiliqit, për shkak të liftit. Unë kam biseduar edhe me juve kryesues, privatisht se është rrezik për zhvendosjen e banorëve sepse aty ka njerëz të sëmurë. Ne kemi kërkuar që e ke edhe me shkrim që me qenë bashkëfinancim edhe nga banorët për një vendosje të liftit. Besoj se është në të mirë të juve si qeveri lokale, por edhe në të mirën tonë si banorë të Obiliqit.

Kryesuesi – Gjithsesi, konsideroj se me rishikim të buxhetit do të aprovohet kjo çështje dhe DSHPE-ja, do të marrë përsipër çështjen teknike se a ka të drejtë, apo nuk ka të drejtë.

Lulzim Sadiku – Pyetja e parë është se ne e kemi ndarë një buxhet për dezinfektimin e mushkonjave, mizave, për 3 vjet, kemi biseduar sa më kujtohet për buxhet, që në fakt të bëhet një kontratë kornizë dhe me qenë në fillim të sezonës sepse e kemi obligim që të iu ndihmojmë qytetarëve. Pyetja e dytë është rruga Sibofc-Hamidi, ka ndodhë një prishje shumë e madhe sa që edhe drejtori i ka hedhë 7,8 kamiona zhavorr edhe nuk ka pasë sukses, prandaj qysh dhe çka duhet të veprohet në këtë drejtim. Pyetja e tretë është shujta e punëtorëve të Komunës sepse ne dy herë kemi marrë vendim, një herë ka qenë vendimi i madh dhe e kemi zvogluar, por nuk është realizue. Pyetja e katërt është se unë në emër të grupit kërkoj që të mendohet dhe punohet rreth shujtës dhe të iu paguhet edhe punëtorëve të Arsimit. Si informatë miqësore po ua japë se një numër i madh i mësimitdhënësve të ciklit të ulët, e kanë lëndën në Gjykatë që veç e kanë fituar. Unë kërkoj derisa dikush që ka shkue në Gjykta ti merrë mjetet, e dikush jo, të merret si rekomandim, të bisedohet, të bashkëpunohet dhe të gjejnë një formë edhe si Kuvend që kemi pasë një suficit, që vërtetë ka pasë vlerë dhe ishin krye shumë punë. Ndoshta, janë shumë pyetje, por mundësisht kisha dashur me mi dhënë përgjegjet.

Kryesuesi – Besoj se Nënkryetari dhe drejtori do të japin përgjegje. Sa i përket shujtës Ministria e ka kthye jo në rishqyrtim dhe e kam dërguar në DEFZH, që të plotësohet, do të thotë të llogaritet buxheti dhe punëtorëve komunal të iu jepen mjetet. Besoj se kjo çështje veç në qershor do të filloj të trajtohet me rishikim të buxhetit.

Hysni Mjeku – Unë e kam një kërkesë, por edhe në seancën e kaluar kam kërkuar për 2 lagje që vërtetë, na mungon një urë e madhe dhe e di se mjetet buxhetore në këtë kohë pandemie ndoshta janë shpenzuar. Mirëpo, dua të di se deri ku ka shkue kërkesa jonë. Sepse kam apelue se nëse, nuk mund të ndërtohet një urë atëherë duhet improvizuar sepse mbi 80 ha tokë, janë në atë pjesën andej lumit, që faktikisht nuk kemi mundësi me i punue. Kërkoj nga Ekzekutivi, se a është ndërmarrë diçka në këtë drejtim sepse kërkesa ka qenë më kohë, do të thotë mbi 2 muaj ditë është kjo kërkesë dhe çka është ndërmarrë në këtë drejtim. Unë

prapë po apeloj që vërtetë, ta gjeni një mundësi që së paku një urë të improvizohet dhe ta kemi në këto 2 lagjet sepse janë 2 lagjet me më shumë banorë se krejtë fshati. Unë e kuptoj se disa prej projekteve janë fokusuar në atë pjesë të atij regjioni, që e falenderoj Ekzekutivin, por mbi të gjitha ura është jetike.

Nazmi Gashi – Unë i kam 70 vjet dhe iu kam thënë njerëzve se po e kryejmë fushën sportive në Sibofc dhe qytetarët e kanë vërejtë se është e nevojshme, i kanë bërë disa fusha aty, ku po na duhen për një zgjidhje shumë të thjeshtë, për një zgjidhje të përbashkët që kemi me bën. Kryetari po ashtu, ka premtuar për shtëpi.

İbush Mjekiqi – I përgjegjem z.Nazmi Gashi, për fushën sportive në fshatin Sibofc, e cila fillon javën tjetër të ndërtohet. Deri më tani kanë filluar të ndërtohen 2 fusha në Grabofc të Epërm dhe në Palaj, është fusha sportive në Sibofc dhe në Breznicë. Ky është një projekt prej 4 fushave sportive. Në Sibofc, do të ndërtohet ose të renovohet ish objekti i administratës për administratën i ndërtuar tash ku është dhe do të bëhet objekt për komunitet. Pra, zgjidhja do të bëhet për tërë Sibofcin, një zgjidhje e përbashkët. Tani, i përgjegjem z.Hysni Mjeku, lidhur me urën që është e vërtetë se kjo është prej 15 janarit kur kanë ndodhë vërshimet, ka ardhë deri te dëmtimi i 3 urave në fshatin Grabofc. Njëra veç ka filluar së ndërtuari, që është ura e cila ka qenë në mes të restorantit dhe pompës. Është në Prokurim ura tjetër që ka qenë ura këmbësore, ndërsa shumë shpejtë është në hartim prej kompanisë dhe është në përfundim e sipër projekti për urën te Abdylët, që i themi. Për lagjen te Abdylët së shpejti do të ndërtohet rruga anësore, që do të kenë qasje në atë pjesën nga Fushë Kosova, është një rrugë atje që i lidhë. Tani, i përgjegjem z.Lulzim Sadiku, lidhur me dezinfektimin se është në procedurë dezinfektimi. Rruga Sobofc-Hamidi, është një rrugë që po ashtu, është dëmtuar gjatë vërshimeve të janarit të këtij viti dhe ajo së shpejti do të fillon së renovuari. Sa i përket shujtës, ne kemi biseduar sot në takimin e mëngjezit me drejtorin e Arsimit dhe kemi kërkuar që të gjendet një zgjidhje për pagesën e shujtës për punëtorët e Arsimit. Drejtori i Arsimit e ka për detyrë që bashkarisht me të tjerët që të arrihet deri te një zgjidhje sepse sipas informatave që ne i posedojmë na duhen 500,000 €, për shlyerjen e obligimeve ndaj punëtorëve arsimor. Tani, i përgjegjem znj.Nora Preniqi për liftet se është shumë e nevojshme, jo vetëm në lagjen që e potencoi ajo por në tërë Obiliqin. Prandaj kishte me qenë mirë që të bëhet një zgjidhje, jo vetëm për atë lagje sepse kemi edhe ndërtesa tjera. Mendoj se duhet të bëhet një projekt pak më i madh dhe të përfshihen të gjithë, por deri më tani në këtë drejtim nuk kemi pas mundësi të angazhohemi. Te pagesa e Komisioneve, është e vërtetë se kam thënë ashtu sepse nuk e kam ditë dhe shumë shpejt do ti keni në xhirlogari mjetet që iu takojnë. Tani, i përgjegjem z.Aziz Bici, se është e vërtetë se rruga kryesore Mazgit-Obiliq, ose rr.Afrim Zhitia është duke u renovuar dhe besoj se sot, ose nesër ajo do të përfundoj në pjesën ku është prerë asfalti. Prandaj duhet me pasë pak durim se kur punohet nuk mund të kryhet brenda ditës. Rasti i familjes Omeroviq Ekrem, i kam angazhuar 2 Drejtorin dhe kemi formuar një Komision, që janë marrë me rastin, por raportin përfundimtar ende nuk e kanë sjellë.

Aziz Bici – Pyeti se prona e kujt është.

İbush Mjekiqi – Përgjegjet nuk e di. Sa i përket Tregut, shumë mirë e dijnë të gjithë anëtarët dhe të gjithë ata që kanë dashur me ditë, që në bisedimet e zhvilluara në mes të hekurudhës dhe qeverisë komunale, është arritë marrëveshja që prona e cila është rreth hekurudhës me një marrëveshje është blerja e asaj toke, është ndërtuar rruga dhe është ndërtuar tregu. Prona, ekskluzivisht është pronë komunale, tash e tutje. Te tregu, jemi në fazën e zbatimit të vendimit për zhvendosjen e ish tregut dhe DSHPE-ja, është në procedurë të hapjes së ofertave për dhënien në shfrytëzim të atyre subjekteve që operojnë në tregun që është, në mënyrë që të iu bëjë zgjidhje, të dalin atje dhe kjo pjesa të filloj të rrenohet. Sa kam informata unë, ajo zonë do të trajtohet dhe do të bëhet parking për vetura.

Aziz Bici – Pyeti se a është bërë pranimi teknik.

İbush Mjekiqi – Përgjegjet po. Mbete borxh të japë një përgjegje nga mbledhja e kaluar për rrugën “Shtabi i UÇK”-së, ka dalë Komisioni e ka verifikuar problemin dhe është në procedurë të zgjidhjes së atij problemi.

Fatos Kurshumlija – Unë nuk e di kur paska dalë Komisioni, por atë rrugë e kam përfunduar vetë, problemin e kanalizimit. Mirëpo, dola me cekë se atë kërkesë ka një vit që e kam bërë, prita një vit prej Komunës, prej shtabit nuk doli askush. Dua të them se në mbledhje drejtori i infrastrukturës nuk është këtu, për atë e pata një pyetje, por pasi nuk është ai po të drejtohem ty. Po ashtu, ka një vit që e kam drejtuar këtë

pyetje, është çështja e rrugës që lidhë fshatin Lajthishtë me Hamidi, definitivisht është në një gjendje shumë të keqe ajo rrugë. Unë e kam cekë nëse, nuk gaboje në vitin 2019, kur kemi qenë në Shqipëri, kur e kemi bërë planin buxhetor për vitin 2020, se në atë rrugë duhet me intervenue. Mirëpo, edhe kur të intervenohet duhet me pasë me kompaninë e ujësjellësit një bashkëpunim që gypat kalojnë në mes të rrugës dhe duhet të vendosen në pjesën anësore.

Armend Rushiti – Herën e fundit keni marrë prapë vendim dhe unë nuk kam qenë prezentë këtu, lidhur me tokën në fshatin Bakshi, do të thotë keni marrë vendim për këmbim të pronës së paluajtshme me atë private të Hashim Rifat Berishës, në fshatin Bakshi. Është hera e 3, ose e 4, që merremi në këtë Kuvend komunal lidhur me këtë çështje, por asnjëherë nuk kemi bërë zgjidhje sepse kjo punë i ka faktikisht është viti i tretë që merremi me këtë çështje dhe nuk e di ku qëndron problemi, pse nuk ka ardhë deri te zgjidhja e kësaj çështjeje. Besoj se është shumë e rëndësishme në emër të Obiliqit, gjegjësisht për fshatin Bakshi, kur dihet se fshati Bakshi në krahasim me zonat tjera, është lënë disi anash.

Kryesuesi – Ne në mbledhjen e fundit e kemi marrë vendimin, por shumë e vështirë ish këmbimi i pronave, unë nuk kam besuar, por ish tepër vështirë.

Armend Rushiti – Pyeti se a kemi të drejtë ne me marrë vendime, kur jemi 6 muaj para zgjedhjeve.

Kryesuesi – Ke të drejtë, por vetëm po bëhet këmbimi i pronës, që është vetëm procedurë.

Armend Rushiti – Kjo çështje po zvarritet dhe nuk e di se ku është problemi, vendimi është marrë, por tash qysh shkojnë procedurat. Duhet me ditë arsye pse nuk është zgjidhë kjo çështje që 3 vjet, kriteret janë që 3 vjet dhe këto kriteret nuk kanë ndryshuar brenda jave.

Kryesuesi - Unë mund të them se Ministria ka kërkuar shumë dokumente, por e di se shumë vështirë ish me dhënë ndonjë propozim me ndërrue pronën komunale me atë private sepse procedurat ishin të jashtëzakonshme, me vite të tëra. Përgjegjen në fund do ta japë drejtori dhe Nënkrjetari.

Ibush Mjekiqi – Ne e kemi pasë të planifikuar ndërtimin e një fushe sportive siç është cekë, por çështja ka dalë siç jemi të informuar të gjithë te këmbimi i pronës. Këtu, nuk është çështja vetëm e dokumenteve të shumta që ka pengue në zbatim të kësaj kërkesë të fshatit Bakshi, por edhe jostabiliteti i qeverive ka ndikue që ky proces të zvarritet që 3 vite. Po ashtu, edhe viti i kaluar e dijmë se ka qenë vit pandemie dhe këto janë arsye kryesore, pse kjo ka ndodhë. Mendoj dhe shpresoj se ky problem zgjidhet, por duhet durim. Sikur të ishte në vendin ku është dashur të ndërtohet fusha, aty sot ishte ndërtue dhe këtu nuk ka çështje që është lënë anash. Kjo nuk është se ne nuk po dojmë, kemi marrë vendim që të ndërtohet dhe po që se ju e jepni pëlqimin që të ndërtohet në atë pjesë, ne jemi në gjendje me ndërtue. Keni kërkuar pronë dhe tash duhet me pritë.

Kryesuesi - Në momentin që ka ardhë nga Ministria e financave vlerësimi i pronës dhe ju duhet ta kuptoni se ne kemi nxjerrë 2 herë vendim, vendimin fillestar dhe vendimin përfundimtar dhe ata e bëjnë vlerësimin metër për metër. Mirëpo, në momentin kur çështja i ka ardhë DPUKP-së, kjo mungesë e institucioneve si dhe pandemia, atëherë Komisioni ka stagnue. Në Ministrinë e financave, duhet me pritë me vite për me bë një vlerësim të pronës, por unë shpresoj se kjo çështje do të kalojë.

Naim Miftari – Kryesues, e thatë edhe ju se këmbimi i pronës komunale me atë private, është pak më vështirë. Në javën e kaluar Ministria ka kërkuar që të bëhet një konfirmim nga Kryetari i Komuës, në mënyrë që në atë lokacion ku është planifikuar të ndërtohet fusha, nuk ka pronë komunale në afërsi të shtëpive të banuara që kishte me i konvenue banorëve të atij lokacioni shfrytëzimi i fushës. Konfirmimi është dërguar dhe ne presim nga Ministria e financave, që të bëhet vlerësimi i pronës.

Mbledhja përfundoi në ora 11:34

Bashk. prof. për punë të KK

Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit komunal

Burim Gërguri